

NJOFTIM PËR VEND PUNE

A- Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive.

Në zbatim të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, kreut IV, “Pranimi në shërbimin civil”, nenit 22 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, njofton se:

Në administratën e tij ka (1) një vend të lirë pune, në pozicionin **specialist informatike në Shërbimin e Teknologjisë së Informacionit.**

a) Kategoria e pagës IV, klasa III-3

b) Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Të mbikqyrë dhe të mirëmbajë punët ditore të rrjetit, ku përfshihet: mirëmbajtja dhe administrimin e internet/intranet, *back-up*, mbrojtjen nga viruset, *e-mail*, dhe sigurisë së rrjetit.
- Të planifikojë, të zhvillojë dhe të bëjë kërkime për implementimin e gjithë skemës së sistemit LAN/WAN, përfshirë specifikimet për software, upgrades, konfigurimin dhe mundësitë e zgjerimit për sistemet dhe të inkurajojë trajnimin e mëtejshëm të personelit në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të monitorojë dhe diagnostifikojë nivelin e sistemit të network–ut për performancën, aksesueshmërinë dhe sigurinë.
- Të instalojë, upgrade, dhe konfigurojë pajisjet e rrjetit routers, switches dhe hubs.
- Të mirëmbajë dhe administrojë faqen WEB.
- Të ruajë, krijojë dhe fshij i llogaritë e përdoruesve sipas kërkesave, dhe të ofrojë sigurinë e rrjetit.
- Të bëjë back-up dhe recovery të sistemeve.
- Të bëjë instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e serverave.
- Të bëjë instalimin e programeve të sistemeve operative për kompjuterët klient.
- Të administrojë pjesën software të sistemit elektronik të votimit, kryesisht problemet me database dhe upgrade të programeve.
- Të ofrojë asistencë teknike për përdoruesit e sistemeve informatike të Kuvendit.
- Të punojë për implementimin e programeve të reja në ndihmë të administratës së Kuvendit.

Marrëdhëniet organizative

Specialisti i informatikës është në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit, raporton dhe përgjigjet para tij për realizimin në afat të detyrave funksionale dhe të detyrave tjera të ngarkuara nga ai.

c) Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë;

- të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- të ketë të paktën një vlerësim pozitiv;
- të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurim.

Kriteret e veçanta për këtë vend pune janë;

- Të ketë diplome universitare DND; DIND ose bachelor + master profesional/ shkencor, në informatikë/inxhinieri informatike, me shkëputje nga puna.
- Të ketë njohuri për:
 - Protokollet e komunikimit në rrjet si TCP/IP, NetBIOS, Netbeui, Ethernet, Token rings.
 - Shërbimet dhe serviset e rrjetit TCP/IP, Active Directory, Group policy, DNS, WINS, DHCP, VPN, IAS, Terminal Services, Routing and Remote Access.
 - Windows server 2000 - Windows server 2012.
 - Sistemet e Operimit, kryesisht Microsoft si windows XP, Win 7, Win 8.
 - Firewall dhe antiviruset.
 - Të ketë njohuri të përgjithshme për database, kryesisht mbi SQL server, Microsoft Exchange, sharepoint, file server, print server, IIS Servers.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese.
- Të jetë i aftë për punën në grup.

ç) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Shërbimin e Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve të Kuvendit (Njësia përgjegjëse), këto dokumente: letër motivimi për aplikim në vendin vakant, një kopje të jetëshkrimit (CV), fotokopje e diplomës, nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njëzuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, fotokopje e listës së notave, nëse ka një diplomë dhe listë notash, të ndryshme me vlerësimin e njohur në shtetin shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar, një fotokopje e librezës së punës e plotësuar, vërtetim i gjendjes gjyqësore, certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme, fotokopje e letërnjoftimit, vërtetimin që nuk ka masë disiplinore në fuqi, vendimi i konfirmimit si nëpunës civil i kategorisë ekzekutive si dhe formularin e vlerësimit të gjashtë mujorit të fundit të punës.

d) Pranimi i dokumenteve do të bëhet deri në **datën 07.02.2025.**

dh) Në **datën 10.02.2025**, do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin (në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut).

Kandidatët e shpallur në listën e publikuar janë ata që plotësojnë kushtet minimale të lëvizjes paralele dhe kushtet e veçanta, të kërkuara më sipër.

-Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë përgjegjëse, brenda 3 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

e) Konkurrimi- intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet **në datën 18.02.2025**, në mjediset e Kuvendit, në orën **10:00**.

ë) Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për specialitetin, Kushtetutën, Ligjin “Për nëpunësin civil”, Kodin e Procedurave Administrative si dhe të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit.

f) Kandidatët do të vlerësohen nga Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele, i ngritur pranë institucionit të Kuvendit të Shqipërisë dhe do të njoftohen për rezultatet.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht: 40 pikë për dokumentacionin dhe 60 pikë për intervistën e strukturuar me gojë (dokumentacioni i dorëzuar, i ndarë: 20 pikë për eksperiencën, 10 pikë për trajnimet apo për kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për vlerësimet pozitive.)

-Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve kalendarike nga njoftimi individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 3 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

g) Njoftimi për fituesin do të bëhet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit **në datën 25.02.2025**.

Për sqarime, mund të kontaktoni me numrin e telefonit +35542278270 dhe +35542278425, ose në adresën: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.4, Tiranë.

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil.

Nëse nuk ka asnjë fitues, nga procedura e lëvizjes paralele, konkurrimi do të vazhdojë sipas kreut IV, “Pranimi në shërbimin civil”, të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, nenit 22 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, kreut II, “Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive”.

B- Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Në zbatim të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, kreut IV, “Pranimi në shërbimin civil” , nenit 22 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, kreut II “Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive”, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë , njofton se:

Në administratën e tij ka (1) një vend të lirë pune, në pozicionin **specialist informatike, në Shërbimin e Teknologjisë së Informacionit.**

b) Kategoria e pagës IV, klasa III-3

Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Të mbikqyrë dhe të mirëmbajë punët ditore të rrjetit, ku përfshihet: mirëmbajtja dhe administrimin e internet/intranet, *back-up*, mbrojtjen nga viruset, *e-mail*, dhe sigurisë së rrjetit.
- Të planifikojë, të zhvillojë dhe të bëjë kërkime për implementimin e gjithë skemës së sistemit LAN/WAN, përfshirë specifikimet për software, upgrades, konfigurimin dhe mundësitë e zgjerimit për sistemet dhe të inkurajojë trajnimin e mëtejshëm të personelit në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të monitorojë dhe diagnostifikojë nivelin e sistemit të network–ut për performancën, aksesueshmërinë dhe sigurinë.
- Të instalojë, upgrade, dhe konfigurojë pajisjet e rrjetit routers, switches dhe hubs.
- Të mirëmbajë dhe administrojë faqen WEB.
- Të ruajë, krijojë dhe fshij i llogaritë e përdoruesve sipas kërkesave, dhe të ofrojë sigurinë e rrjetit.
- Të bëjë back-up dhe recovery të sistemeve.
- Të bëjë instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e serverave.
- Të bëjë instalimin e programeve të sistemeve operative për kompjuterët klient.
- Të administrojë pjesën software të sistemit elektronik të votimit, kryesisht problemet me database dhe upgrade të programeve.
- Të ofrojë asistencë teknike për përdoruesit e sistemeve informatike të Kuvendit.
- Të punojë për implementimin e programeve të reja në ndihmë të administratës së Kuvendit.

Marrëdhëniet organizative

Specialisti i informatikës është në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit, raporton dhe përgjigjet para tij për realizimin në afat të detyrave funksionale dhe të detyrave tjera të ngarkuara nga ai.

ç) Kërkesat e përgjithshme për këtë vend pune janë;

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotrojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

dh) Kriteret e veçanta për këtë vend pune janë:

- Të ketë diplome universitare DND; DIND ose Bachelor + Master Profesional / Shkencor, në Informatikë/Inxhinieri informatike, me shkëputje nga puna.
- Të ketë njohuri për:
 - Protokollat e komunikimit në rrjet si TCP/IP, NetBIOS, Netbeui, Ethernet, Token rings.
 - Shërbimet dhe serviset e rrjetit TCP/IP, Active Directory, Group policy, DNS, WINS, DHCP, VPN, IAS, Terminal Services, Routing and Remote Access.
 - Windows server 2000 - Windows server 2012
 - Sistemet e Operimit, kryesisht Microsoft si windows XP, Win 7, Win 8,
 - Firewall dhe antiviruset.
 - Të ketë njohuri të përgjithshme për database, kryesisht mbi SQL server.
 - Microsoft Exchange, Sharepoint, File server, print server, IIS Servers.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese.
- Të jetë i aftë për punën në grup.

e) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Shërbimin e Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve të Kuvendit (Njësia përgjegjëse), këto dokumente: letër motivimi për aplikim në vendin vakant, një kopje të jetëshkrimit (CV), fotokopje e diplomës, nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njëzuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, fotokopje e listës së notave, nëse ka një diplomë dhe listë notash, të ndryshme me vlerësimin e njohur në shtetin shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar; një fotokopje e librezës së punës e plotësuar, vërtetim i gjendjes gjyqësore, certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme, fotokopje e letërnjoftimit.

ë) Pranimi i dokumenteve do të bëhet deri në **datën 12.02.2025**.

f) Në **datën 26.02.2025**, do të shpallet **lista e vlerësimit paraprak** të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut.

-Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

g) Njoftimi dhe komunikimi me kandidatët do të bëhet nëpërmjet njoftimeve në Portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit, faqen zyrtare të Kuvendit, telefon dhe e-mail.

gj) Konkurrimi-**testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë** do të zhvillohet në **datën 10.03.2025**, në mjediset e Kuvendit, në orën **10-00**.

Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për specialitetin, Kushtetutën, Ligjin “Për nëpunësin civil”, Kodin e Procedurave Administrative si dhe të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit.

h) Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimi, i ngritur pranë institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. **Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100**, të cilat ndahen përkatësisht: vlerësimi i jetëshkrimit - **15 pikë**, intervista e strukturuar me gojë - **25 pikë** dhe testimi me shkrim - **60 pikë**.

j) Ankesat nga kandidatët do të paraqiten në Komitetin e Përhershëm të Pranimi, brenda 5 ditëve kalendarike nga njoftimi individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

k) Shpallja e listës përfundimtare të fituesve do të bëhet në **datën 17.03.2025**, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut.

Për sqarime, mund të kontaktoni me numrin e telefonit +35542278270 dhe +35542278425, ose në adresën: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.4, Tiranë.